



Kryesuesi i Këshillit Akademik
Prof. Dr. Sc. Mevlan Bixhaku

Nr. Prot.: _____, Data e aprovimit: 07.05.2025, Version i rishikuar

Rregullore për Digjitalizim të Kolegjit

Kjo rregullore është hartuar dhe nxjerrë në përputhje të plotë Statutin të Kolegjit Tempulli në Prishtinë dhe është aprovuar nga Këshillit Akademik në mbledhjen e mbajtur më 07.05.2025.

Neni 1

Digjitalizimi i mësimdhënies

Kolegjit përmes hartimit, menaxhimit, ruajtjes dhe aplikimit të sistemit të digjitalizuar dhe i bazës së të dhënave për studentë e personelin, platformës SEMS ka digjitalizuar procesin e mësimdhënies dhe menaxhimit të studentëve dhe stafit.

Udhëzuesi për përdorim të sistemit digjital SEMS duhet të dërgohet tek studentët dhe stafi i Kolegjit dhe Trajnimeve para fillimit të vitit akademik respektivisht fillimit të trainimeve.

Po ashtu, përmes këtij neni, obligohet Institucioni që të Aplikoje ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë aplikimit të sistemeve të ndryshme të digjitalizuar të mësimdhënies e të studimeve.

Rregullorja parasheh që gjatë dy viteve të ardhshme të krijohen mundësi për testimin online të studentëve.

Neni 2

Digjitalizimi i administratës

Digjitalizimi i shërbimeve administrative do të përfshijë edhe sistemin e digjitalizuar të menaxhimit të të dhënave administrative të personelit, përfshirë edhe e Portfolion e personelit të Kolegjit.

Ky nen obligon institucionin që të bëjë:

- Hartimin e udhëzuesve për përdorim të sistemit digjital;
- Trajnimin personelit mbi përdorimin e teknologjisë digjitale;
- Implementimin e Sistemit në baza të rregullta.

Neni 3

Digjitalizimi i shërbimeve studentore

Krahas shërbimeve të vazhdueshme për studentët, përmes zyrave përkatëse, Kolegjit do të siguroj të gjitha shërbimet elektronike përmes platformave të ndryshme digjitale. Shërbimet tona elektronike ofrojnë mbështetje dhe udhëzim të studentëve që nga pranimi, përkrahja financiare, regjistrimi, gjatë studimeve dhe pas diplomimit. Të gjitha këto shërbime kanë për qëllim që të sigurojnë përkrahje efektive dhe konsistente për studentët dhe të realizojnë politikat e programet e Kolegjit për shërbime inovative arsimore dhe kurrikulare në përputhje me misionin dhe politikat e Kolegjit në programe. Kolegji tashmë ka në dispozicion një sërë shërbimesh të digjitalizuara, mirëpo në ndërkohë është krijuar komisioni dhe janë ndarë fondet për të avancuar më tej këto sisteme.

Shërbimet elektronike për studentët, të cilat janë në dispozicion dhe do të avancohen më tutje janë si në vijim:

- **Uebmail:** Përmes këtij sistemi, arrihet komunikimi me të gjithë studentët, qoftë në mënyrë individuale apo edhe komunikim me grupe të caktuara. Të gjithë studentët e Kolegjit, përfshirë edhe studentët e trajnimeve profesionale, por edhe stafi akademik, posedojnë llogarinë e tyre në domenin tonë, gjë që mundëson komunikimin e vazhdueshëm mes vete;

SEMS: Është platformë digjitale, e cila ndihmon që studenti të jetë i shërbyer 24 orë, edhe pa prezencën e tij në hapësirat e Kolegjit. Përmes këtij shërbimi, studentët do të kenë qasje të vazhdueshme në informacionet që kanë të bëjnë me zhvillimet në Tempull. Studentit i mundësohet që përmes kësaj platforme, të regjistrojë semestrat; të përcaktojë lëndët që dëshiron të ndjekë; të shkarkojë materialet që shpërndajnë mësimdhënësit; të paraqesin provimet; të marrin rezultatet e tyre; dhe shumë mundësi të tjera;

– Kolegjit do të mundësojë edhe shtypjen online dhe të përshtatur (customized) sipas nevojave të studentëve të certifikatave të ndryshme studentore (eKiosK);

– **SMS/Viber/Whatsup:** Përmes mesazheve telefonike SMS, të gjithë studentët e Kolegjit njoftohen në kohë reale me lajmet dhe informacionet që janë të rëndësishme për ta.

– **TV Monitorat** – Të gjitha klasat e Kolegjit Tempulli do të jenë të pajisura me Smart TV, të cilat do të shërbejnë për një qasje proaktive me studentë. Po ashtu, TV monitorat janë të vendosur edhe nëpër korridore të Kolegjit me qëllim të informimit të studentëve.

– **Moodle (E-learning)** është një platformë e të mësuarit e dizenuar për tu mundësuar stafit dhe nxënësve që me anë të një sistemi të fuqishëm, të sigurt dhe të integruar, të krijojnë ambiente të të mësuarit të personalizuar. Secili studentë dhe profesor në Kolegjin Tempulli është i obliguar të përdorë E-learning, ku profesori obligohet që të gjitha materialet/testet/rastet e studimit ti vendos në platformë, ndërsa studentët ti përdorin ato, ti dorëzojnë detyrat etj.

– **Microsoft Teams** - Microsoft Teams është platformë e unifikuar e komunikimit dhe bashkëpunimit që kombinon biseda të vazhdueshme në Kolegji, video-takime, ruajtje skedarësh dhe integrim të aplikacioneve. Përmes Teams, të gjithë stafi dhe studentët e Kolegjit do të kenë qasje në të gjitha shërbimet që i ofron platforma si dhe të ndjekin mësimin online.

Neni 4

Ligjëratat online

Për shkak të kërkesave dhe proceseve të digjitalizimit të Institucionit, Kolegji të gjitha ligjëratat për studentë në studime bachelor dhe master si dhe për pjesëmarrësit e trajnimeve do të ofroj edhe ligjëratat online, të cilat do të mbahen paralel edhe fizikisht në hapësirat e Kolegjit. Qasja në ligjëratat online do të mundësohet përmes emailit zyrtarë/studentor të Tempullit, dhe linku paraprakisht për secilën ligjëratë do të vendoset në Moodle. Ligjëratat janë autoriale dhe nuk kanë të drejtë të incizohen as nga pjesëmarrësit dhe as nga Kolegjit. Pjesëmarrja në ligjëratat të studimeve dhe trajnimeve online evidentohet dhe vlerësohet në mënyrë të njëjte sikurse prezenca fizike. Por, nuk lejohen mbajta e provimeve dhe testimeve online për shkak të mbrojtjes nga kopjimi eventual.

Neni 5

Kjo rregullore hynë në fuqi në momentin e nënshkrimit dhe e shfuqizon rregulloren me nr.007/20 të datës 28.12.2020.

Kryesuesi i Këshillit Akademik
Prof. Dr. Sc. Mehmet Bixhak

